



POZHEGU BROTHERS SH.P.K.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e përfunduar
më 31 dhjetor 2025

dhe

Raporti i Auditorit të Pavarur



Emri biznesit: Pozhegu Brothers SH.P.K.
NUI: 811251032
Adresa: Prishtinë, Muharrem Fejza MATI -1 Bll.C11/ A1 Lok.4

Deklaratë e Pajtueshmërisë

- Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.2025 -

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2025 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në Pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit 06-/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.


Qemall Pozhegu
Pronar dhe Drejtor Ekzekutiv




Mergim Bekteshi
Kontabilist i Certifikuar



Prishtinë - 24 prill 2026

PËRMBAJTJA:

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR.....	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
1. Informata të përgjithshme mbi kompaninë.....	7
2. Politikat materiale kontabël	7
3. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit.....	12
5. Paraja dhe ekuivalentët e parasë.....	16
6. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	16
7. Stoqet.....	16
8. Prona, impiantet dhe pajisjet	17
9. Investimet në vijim.....	17
10. Llogaritë e pagushme tregtare dhe tjera	18
11. Huatë financiare.....	18
12. Të hyrat.....	19
13. Kosto e mallit të shitur.....	19
14. Shpenzimet e pagave.....	19
15. Shpenzimet operative dhe administrative	20
16. Shpenzimet financiare, neto	21
17. Tatimi në fitim	21
18. Kontigjencat dhe zotimet	22
19. Ngjarjet pas datës së raportimit	22

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR PËR MENAXHMENTIN E "POZHEGU BROTHERS" SH.P.K.

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "Pozhegu Brothers" SH.P.K. ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç çështjeve të shpalosura në paragrafin Baza për Opinion me Rezervë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitive financiare të Kompanisë më 31 dhjetor 2025 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM).

Baza për Opinion me Rezervë

- Siç është paraqitur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet rregullimi në vlerë 226,166 euro për vitin 2025 si dhe rregullimi në vlerë (301,563) euro për vitin 2024, për shkak natyrës dhe mungesës së dëshmive, ne përmes procedurave alternative të auditimit nuk ishim në gjendje të përftojme siguri të mjaftueshme mbi saktësinë e rregullimit të fitimeve të mbajtura në vlerë 226,166 euro. Gjithashtu nuk arritëm të vlerësojmë efektet e mundshme që mund të rrjedhin mbi pozitën financiare të kompanisë dhe rrjedhën e parasë për vitin 2025 nga kjo pasiguri materiale.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF për NVM dhe për kontrollin e tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit të zërit dhe vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likujdohë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprave në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Berisha
Auditor ligjor



bakertilly
Baker Tilly Kosovo L.L.C
Prishtinë

Baker Tilly Kosovo
24 prill 2026

POZHEGU BROTHERS SH.P.K.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat në Euro

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	2,366,098	1,255,200
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	7,466,168	4,941,623
Stoqet	6	2,749,795	2,060,910
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		12,582,061	8,257,733
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe implantet	7	1,891,494	1,814,721
Investimet në vijim	8	14,401,498	12,623,077
Gjithsej pasuritë afatgjata		16,292,992	14,437,798
Gjithsej pasuritë		28,875,053	22,695,531
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	9	5,234,206	4,642,290
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	10	3,419,674	4,162,986
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		8,653,880	8,805,275
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	10	3,166,148	2,455,977
Gjithsej detyrimet afatgjata		3,166,148	2,455,977
Gjithsej detyrimet		11,820,028	11,261,253
EKUITETI			
Kapitali akisonar	11	10,000	10,000
Fitimet e mbajtura		17,045,025	11,424,278
Gjithsej ekuiteti		17,055,025	11,434,278
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		28,875,053	22,695,531

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe aprovuar nga menaxhmenti i "Pozhegu Brothers" SH.P.K. dhe janë nënshkruar më 24 mars 2026 në emër të:

Oemali Pozhegu
Pronar dhe Drejtor Ekzektiv

Mergim Bekteshi
Kontablisti i Certifikuar

Shënimet e bashkangjitura në faqet 7 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

POZHEGU BROTHERS SH.P.K.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat në Euro

Për vitin që përfundon	Shënimi	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Të hyrat	12	23,164,289	13,247,024
Kosto e shitjes	13	(15,771,845)	(8,697,670)
Fitimi / (humbja) bruto		7,392,444	4,549,354
Shpenzimet e zhvlerësimit	7	(101,651)	(168,492)
Shpenzimet e pagave	14	(420,165)	(1,064,046)
Shpenzimet operative dhe administrative	15	(750,277)	(561,660)
Fitimi / (humbja) operativ		6,120,350	2,755,156
Fitimi / (humbja) kapitale		6,234	2,119
Shpenzimet financiare	16	(157,497)	(469,176)
Të ardhurat financiare		32,187	39,933
Fitimi / (humbja) para tatimit		6,001,274	2,328,032
Shpenzimet e tatimit në fitim	17	(606,694)	(237,669)
Fitimi / (humbja) neto i/e vitit		5,394,581	2,090,363

Shënimet e bashkangjitura në faqet 7 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

POZHEGU BROTHERS SH.P.K.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat Euro

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 31 dhjetor 2023	10,000	9,635,478	9,645,478
Fitimi / (humbja) neto i/e vitit	-	2,090,363	2,090,363
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-
Dividentat	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-
Rregullimet për fitimet e mbajtura	-	(301,563)	(301,563)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	10,000	11,424,278	11,434,278
Fitimi / (humbja) neto i/e vitit	-	5,394,581	5,394,581
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-
Dividentat	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-
Rregullimet për fitimet e mbajtura	-	226,166	226,166
Gjendja më 31 dhjetor 2025	10,000	17,045,025	17,055,025

Shënimet e bashkangjitura në faqet 7 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

POZHEGU BROTHERS SH.P.K.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat Euro

Për vitin që përfundoi	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
AKTIVITETI OPERATIV		
<u>Fitimi / (humbja) i/e vitit</u>	<u>5,394,581</u>	<u>2,090,363</u>
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	101,651	168,492
Korrigjimet e zhvlerësimit	(28,666)	-
Shpenzimet financiare	157,497	469,176
Shpenzimet e tatimit në fitim	606,694	237,669
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	(688,885)	576,873
(Rritja) / zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(2,524,545)	(969,635)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	591,917	1,758,094
Tatimi në fitim i paguar	(606,694)	(237,669)
Interesi financiar i paguar	(157,497)	(469,176)
<u>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</u>	<u>2,846,053</u>	<u>3,624,187</u>
AKTIVITETI INVESTUES		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(199,082)	(1,416,693)
Pagesa për investime në vijim	(1,778,421)	(1,619,142)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	49,323	-
Rregullimet e kostos së aseteve	-	(813)
<u>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</u>	<u>(1,928,180)</u>	<u>(3,036,648)</u>
AKTIVITETI FINANCIUES		
Rrjedha monetare nga kreditë bankare	(33,141)	210,290
Rregullimet për fitimet e mbajtura	226,166	(301,564)
<u>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</u>	<u>193,025</u>	<u>(91,274)</u>
<u>Rritja / (zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</u>	<u>1,110,898</u>	<u>496,264</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	1,255,200	758,936
<u>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</u>	<u>2,366,098</u>	<u>1,255,200</u>

Shënimet e bashkangjitura në faqet 7 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informata të përgjithshme mbi kompaninë

Kompania Pozhegu Brothers SH.P.K. është regjistruar në Agjensin e bizneseve të Kosovës si ndërmarrje tregtare ligjore më date 04/08/2008. Numri unik identifikues i kompanisë është 811251032 dhe është e regjistruar si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Agjent i regjistruar (drejtor general) i kompanisë është Qemajl Pozhegu.

Kompania aktivitetet primar ka Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore. Aktivitete tjera afariste të kompanisë janë: formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët, prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari etj. Kompania është në pronësi të Qemajl Pozhegu me 50% të aksioneve dhe Shefqet Pozhegu me 50% të aksioneve. Kapitali aksionar i regjistruar në ARBK ka vlerën 10,000 Euro.

Adresa e kompanisë: Rruga: Muharrem Fejza MATI -1 Bll.C11/ A1 Lok.4 – Kosovë.

Gjatë vitit 2025 kompania ka pasur të punësuar mesatarisht 128 të punësuar.

2. Politikat materiale kontabël

Politikat materiale kontabël të paraqitur në vazhdim janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare, dhe janë aplikuar në vazhdimësi nga entiteti.

2.1. Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme ('SNRF për NVM'), si të përshtatshme për entitetet që realizojnë profit për aksionarin.

Konventa e kostos historike. Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas metodës së kostos historike, përveç rasteve kur, sipas nevojës, është kryer rivlerësimi i aktiveve dhe pasiveve financiare në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, pronave investuese, klasave të caktuara të pronës, pajisjeve dhe impianteve, si dhe instrumenteve financiare derivate.

Vlerësimet kritike kontabël. Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike kontabël. Gjithashtu kërkohet që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Fushat që kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose ato ku supozohet që vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, paraqiten në shënimin 3.

2.2. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Monedha funksionale e Kompanisë është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon entiteti. Monedha funksionale e entitetit dhe monedha e prezantimit është Euro ("EUR"), e cila është monedha ligjore në Republikën e Kosovës.

2.3. Transaksionet dhe balancat në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përkthehen në njësi monetare ndërkombëtare duke përdorur kursin e këmbimit në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, që rezultojnë nga mbyllja e këtyre transaksioneve dhe nga përkthimi në kurset e këmbimit të fundvitit financiar të aktiveve dhe pasiveve monetare të shprehura në valuta të huaja, njihen në fitim ose humbje.

2.4. Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti, në kohën e miratimit të pasqyrave financiare, kanë një pritje të arsyeshme që Entiteti të ketë burime të përshtatshme për të vazhduar ekzistencën operacionale për një të ardhme të parashikueshme. Kështu që ata vazhdojnë të adoptojnë bazën e vijimësisë të kontabilitetit në përgatitjen e pasqyrave financiare. Menaxhmenti, pasqyrat financiare përgatiti sipas parimit të vijimësisë.

2.5. Prona, impiantet dhe pajisjet.

i) Njohja dhe matja

Prona dhe pajisjet janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe minus humbjet nga dëmtimi i asetit, nëse ka. Kostoja përfshinë të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së artikujve. Shpenzimet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të aseteve ose njihen si një aset i veçantë, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me artikullin do të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin. Kur pjesët e një artikulli të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme ato llogariten si zëra të veçantë (përbërës kryesorë) të pronës dhe pajisjeve. Softueri i blerë i cili është kyç për funksionalitetin e pajisjeve kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje. Fitimet dhe humbjet nga heqja prej përdorimit të pronave, impianteve dhe pajisjeve përcaktohen duke krahasuar të ardhura nga largimi apo shitja me vlerën kontabël të pasurisë më datë, dhe ato njihen si fitim apo humbje kapitale.

ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese përshihen në vlerën kontabël të aktivit ose njihen si aktiv i veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me artikullin do të rrjedhin tek Entiteti dhe kostoja e artikullit mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtja e përditshme shpenzohen kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve kryesore ose komponentëve të pronave dhe pajisjeve kapitalizohet dhe pjesa e zëvendësuar largohet nga llogaritja.

Në fund të çdo date të raportimit, menaxhmenti vlerëson nëse ka ndonjë tregues për dëmtim të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, menaxhmenti vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një asemi me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim.

Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi (dëmtimi) njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga rënia në vlerë (dëmtimi) e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e heqjes nga përdorimi.

iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet mbi shumën e zhvlerësueshme, që është kostoja e një aktivi, ose shuma tjetër që e zëvendëson atë, zvogëluar (minus) vlera saj e mbetur deri më datë. Përpos aktivieve tjera, toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i zërave të tjerë të pronës, impianteve dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar:

	Jetë të dobishme në vite
Ndërtesat	20 vite
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vite
Automjete	5 vite
Pasuri tjera të trupëzuara	10 vite

Vlera e mbetur e një asemi është vlera e parashikuar që Kompania aktualisht do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit e asetit minus kostot e vlerësuara të nxjerrjes jashtë përdorimit, nëse asemi ishte tashmë në moshë dhe në gjendje që pritët të jetë në fund të jetës së saj të dobishme.

Vlerat e mbetura të aseteve dhe jetët e dobishme rishikohen, dhe korrigjohen nëse është e përshtatshme, në fund të çdo periudhe raportuese.

2.6. Pasuritë e paprekshme

i) Njohja dhe matja

Pasuritë e patrupëzuara të cilat janë blerë nga Entiteti, maten me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi, nëse ka.

ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të materializuara në një pasuri specifike me të cilën ato lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera duke përfshirë shpenzimet për emrin e mirë dhe markën, njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, në momentin e ndodhjes.

iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e pasurisë apo aktivitetit minus vlera e mbetur. Amortizimi është njohur në pasqyrën e të ardhurave apo humbjes gjithpërfshirëse duke përdorur metodën lineare për programet kompjuterike, me një normë amortizimi vjetor prej 20%.

2.7. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në dorë, depozitat e mbajtura në thirrje me bankat dhe investime të tjera afatshkurtra shumë të lëngëta me maturim origjinal prej tre muajsh ose më pak. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbarten me koston e amortizuar sepse: (i) janë mbajtur për arkëtimin e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe (ii) ato nuk janë të përcaktuara në FVTPL. Karakteristikat e mandatuara vetëm nga legjislacioni, siç është legjislacioni për lirin me kusht në vende të caktuara, nuk kanë ndikim në testin e SPPI, përveç nëse ato janë të përfshira në terma kontraktuale në mënyrë që funksioni të zbatohet edhe nëse legjislacioni më vonë ndryshohet.

2.8. Stoqet

Stoqet paraqiten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe, aty ku është e aplikueshme, kostot direkte të punës dhe ato shpenzime të përgjithshme që janë shkaktuar për të sjellë stoqet në vendndodhjen dhe gjendjen e tyre aktuale. Kostoja llogaritet duke përdorur metodën e kostos mesatare të ponderuar. Vlera neto e realizueshme përfaqëson çmimin e vlerësuar të shitjes minus të gjitha kostot e vlerësuara të përfundimit dhe kostot që do të ndodhin në marketing, shitje dhe shpërndarje.

2.9. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare, janë pasuri afatshkurtra që përfaqësojnë kërkesat e kompanisë ndaj klientëve për mallra ose shërbime të shitura me kredi. Ato regjistrohen fillimisht në vlerën e drejtë dhe më pas maten në koston e amortizuar, duke përfshirë çdo provizion për rënie në vlerë kur ka prova se nuk do të mbledhen plotësisht.

2.10. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare përfaqësojnë detyrimet afatshkurta të kompanisë për mallrat dhe shërbimet e marra nga furnitorët në periudhën e raportimit dhe që janë të papaguara në fund të periudhës. Llogaritë e pagueshme regjistrohen fillimisht në vlerën e drejtë, e cila zakonisht është e barabartë me vlerën e faturës së furnitorit, dhe më pas ato mbahen sipas kostos së amortizuar. Llogaritë e pagueshme janë të pasiguruara dhe zakonisht shlyhen brenda afatit të rënë dakord me furnitorët. Nëse ndonjë detyrim paguhet me vonësë, kompania mund të jetë e detyruar të paguajë interes ose penalitete, të cilat regjistrohen veçmas si shpenzime financiare.

2.11. Kreditë dhe huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksionit të ndodhura dhe mbahen më pas në kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.12. Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme dhe dividendët diskrecionalë klasifikohen të dyja si kapital. Kapitali aksionar i Kompanisë njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital aksionar.

2.13. Dividendët

Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, janë të shpalosura në shënimet e ngjarjeve të mëvonshme.

2.14. Të hyrat

Njësia ekonomike mat të ardhurat me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke përfshirë zbritjet tregtare, zbritjet për pagesa të menjëhershme dhe taksat e mbledhura në emër të palëve të treta. Për pagesat e shtyra që përbëjnë transaksione financiare, të ardhurat llogariten si vlera aktuale e arkëtimeve të ardhshme, duke përdorur një normë interesi të përcaktuar. Njohja e të ardhurave bëhet kur janë transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore të pronësisë, kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme dhe kur ekziston siguri për hyrjen e përfitimeve ekonomike

Shitja e mallrave

Të ardhurat njihen kur transferohen rreziqet dhe përfitimet kryesore të pronësisë tek blerësi, kur ndodh mungesa e kontrollit ose përfshirjes në menaxhimin e mallrave të shitur, kur është e mundshme matja e besueshme e të ardhurave dhe kostove lidhur me to dhe përfitimet ekonomike janë të mundshme.

Shitja e shërbimeve

Të ardhurat njihen bazuar në fazën e përfundimit të transaksionit ose linear për shërbime të vazhdueshme. Njohja e të ardhurave nga shërbimet bëhet kur të ardhurat dhe kostot mund të maten me besueshmëri, përfitimet ekonomike pritet të realizohet dhe faza e përfundimit mund të matet saktë. Kur rezultati i transaksionit nuk mund të vlerësohet, të ardhurat do të njihen në masën e shpenzimeve të rikuperueshme.

Të hyrat tjera

Të hyrat tjera njihen kur pranohen ose kur është përcaktuar e drejta për të pranuar pagesën.

2.15. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore: Kompania kontribuon vetëm në planin e pensioneve të administruara publikisht, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (KPST), siç kërkohej me ligj. Kompania nuk ka detyrime të mëtejshme të pagesës pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzime për përfitimet e punonjësve kur ato janë për shkak. Kompania nuk ka detyrime të mëtejshme ndaj punonjësve të saj përtej këtyre kontributeve.

2.16. Përfitimet pensionale

Kompania nuk njih ndonjë provizion dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi kontributet e përshkruara në këtë shënim.

2.17. Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhurat aktuale llogaritet në bazë të rregullave të tatimit mbi të ardhurat të aplikueshme në Kosovë, duke përdorur normat e tatimit të miratuara në datën e raportimit. Në fuqi nga 19 korrik 2019 norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është 10% në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës që aktualisht janë në fuqi, Ligji nr. 06 / L-105 "Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave".

Tarifa e tatimit mbi të ardhurat në fitim ose humbje për vitin përbëhet nga tatimi aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të tatueshëm të pritur për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje sepse ajo përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vite të tjera dhe përveç kësaj përjashton zërat që nuk janë kurrë të tatueshëm ose të zbritshëm. Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

2.18. Qiraja operative

Kompania ndjek politikat e kontabilitetit për qiratë operative në përputhje me SNRF për NVM. Qiraja operative përkufizohet kur kontratat e qirasë nuk përfshijnë transferimin e rrezikut dhe përfitimeve të pronësisë dhe nuk regjistrohen si asset në pozitën financiare të kompanisë. Pagesat e qirasë operative janë regjistruar si shpenzime në periudhën përkatëse, pra kur ato ndodhin.

Shpalosjet e mëposhtme janë bërë për të ofruar një pasqyrim të qartë për angazhimet e kompanisë nga qiratë operative.

Kompania, si qiramarrës përcakton totalin e pagesave minimale të ardhshme të qirasë sipas kontratës së qirasë së zakonshme të paanulueshme, për periudhat si mëposhtë:

- a) Jo më vonë se një vit;
- b) Më vonë se një vit, por jo më vonë se pesë vite;
- c) Më vonë se pesë vjet;

Opsionet e rinovimit dhe blerjes:

Disa marrëveshje të qirasë mund të përfshijnë mundësinë e rinovimit të kontratës ose mundësinë për blerjen e pasurisë nga qiramarrësi pas përfundimit të periudhës së qirasë për një çmim të paracaktuar.

Klauzolat e përshkallëzimit:

Në disa raste, kontratat e qirasë përmbajnë klauzola për përshkallëzimin e pagesave të qirasë gjatë periudhës së marrëveshjes.

Kufizimet e vendosura në marrëveshjet e Qirasë:

Mund të përfshijnë kufizime për përdorimin e pasurisë, si dhe kërkesa për miratim të ndryshimeve që lidhen me pasurinë me qira.

2.19. Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet që rrjedhin nga huamarrjet dhe kreditë. Si të tilla ato regjistrohen si kosto financiare në periudhën në të cilën ndodhin.

2.20. Tatimi mbi vlerën e shtuar ("TVSH")

Tatimi mbi vlerën e shtuar të produktit që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore më herët a) mbledhjen e të arkëtueshmeve nga konsumatorët ose b) dërgimin e mallrave ose shërbimeve ndaj klientëve. TVSH-ja e inputeve në përgjithësi mund të rikthehet kundrejt TVSH-së së outputeve pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja e lidhur me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe shpaloset veçmas si një aktiv dhe pasiv. Kur janë bërë provizionet për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

3. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara në pasqyrat financiare. Menaxhmenti rishikon vazhdimisht gjykimet dhe vlerësimet në lidhje me asetet, detyrimet, detyrimet e mundshme, të ardhurat dhe shpenzimet. Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme që menaxhmenti i konsideron të arsyeshme në rrethanat përkatëse. Gjykimet dhe vlerësimet kontabël që rezultojnë rrallë përputhen plotësisht me rezultatet faktike. Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të rëndësishëm për të shkaktuar një ndryshim material në vlerën mbartëse të aseteve dhe detyrimeve (shih shënimet përkatëse) brenda vitit financiar të ardhshëm, janë diskutuar më poshtë.

Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti i përgatiti këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Në ushtrimin e këtij gjykimi, menaxhmenti mori në konsideratë pozicionin financiar të kompanisë, synimet aktuale, përfitimin e operacioneve dhe qasjen në burimet financiare, si dhe analizoi ndikimin e zhvillimeve makroekonomike në aktivitetin e kompanisë.

Provizioni për rënien në vlerë të inventarëve

Vlerësimi i provizionit për rënien në vlerë të inventarëve kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Niveli i provizionit vlerësohet duke marrë parasysh përvojën e fundit të shitjeve, vjetërsinë e inventarëve dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në mospërdorshmërinë e inventarit.

Vlerësimi i jetëgjatësisë së dobishme të aseteve

Kompania përcakton jetëgjatësinë e pritshme të dobishme dhe kostot përkatëse të amortizimit dhe zhvlerësimit për pronën, pajisjet dhe asetet e saj të paprekshme me jetë të kufizuar. Jetëgjatësia e dobishme mund të ndryshojë ndjeshëm si rezultat i inovacioneve teknologjike ose ngjarjeve të tjera. Shpenzimet e amortizimit dhe zhvlerësimit do të rriten nëse jetëgjatësia e dobishme rezulton të jetë më e shkurtër nga sa ishte vlerësuar më parë, ose asetet që janë teknologjikisht të vjetruara apo jostrategjike, të cilat janë braktisur apo shitur, do të zhvlerësohen apo shlyhen nga regjistrat financiarë.

Taksat mbi të ardhurat

Kompania i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat në juridiksionet ku operon. Për përcaktimin e provizionit për tatimin mbi të ardhurat kërkohet një shkallë e rëndësishme gjykimi. Ka shumë transaksione dhe llogaritje të kryera gjatë aktivitetit të zakonshëm të biznesit për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurt. Kompania njeh detyrime për çështjet e pritshme nga auditimet tatimore, bazuar në kuptimin aktual të ligjit tatimor. Nëse rezultati përfundimtar i këtyre çështjeve ndryshon nga shumat e regjistruara, këto ndryshime do të ndikojnë në provizionet për tatimin aktual dhe të shtyrë gjatë periudhës kur përcaktimi bëhet.

3. Instrumentet financiare – menaxhimi i rrezikut

Kompania është e ekspozuar nëpërmjet operacioneve të saj ndaj rreziqeve financiare të mëposhtme:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i normës së interesit
- Rreziku i këmbimit valutor
- Rreziku tjetër i çmimit të tregut, dhe
- Rreziku i likuiditetit

Ashtu si të gjitha bizneset e tjera, Kompania është e ekspozuar ndaj rreziqeve që rrjedhin nga përdorimi i instrumenteve financiare. Ky shënim përshkruan objektivat, politikat dhe proceset e Kompanisë për menaxhimin e këtyre rreziqeve dhe metodat e përdorura për matjen e tyre.

Informacione të mëtejshme sasiore në lidhje me këto rreziqe paraqiten përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka pasur ndryshime thelbësore në ekspozimin e kompanisë ndaj rreziqeve të instrumenteve financiare, objektivat, politikat dhe proceset e saj për administrimin e këtyre rreziqeve ose metodat e përdorura për matjen e tyre nga periudhat e mëparshme, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë shënim.

(i) Instrumentet kryesore financiare

Instrumentet kryesore financiare të përdorura nga Kompania, nga të cilat lind rreziku i instrumentit financiar, janë si më poshtë:

- Të arkëtueshmet tregtare
- Paratë dhe ekuivalentët e saj
- Të pagueshmet tregtare dhe të tjera
- Overdraftet bankare
- Kredi bankare me normë të ndryshueshme
- Kredi bankare me normë fikse

(ii) Instrumentet financiare sipas kategorive

Pasuritë financiare

	Kosto e amortizuar	
	Me 31 dhjetor 2025	Me 31 dhjetor 2024
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	2,366,098	1,255,200
Të arkëtueshmet tregtare dhe tjera	7,466,168	4,941,623
Gjithsej pasuri financiare	9,832,266	6,196,823

Detyrimet financiare

	Kosto e amortizuar	
	Me 31 dhjetor 2025	Me 31 dhjetor 2024
Të pagueshme tregtare dhe tjera	5,234,206	4,642,290
Kredi dhe huazime	6,585,822	4,162,986
Gjithsej detyrime financiare	11,820,028	8,805,275

4. Instrumentet financiare – menaxhimi i rrezikut (*vazhdim*)

(iii) Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë

Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë përfshijnë paratë dhe ekuivalentet e saj, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, të pagueshmet tregtare dhe të tjera, si dhe kreditë dhe huatë. Për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër, vlera kontabël e parave dhe ekuivalentëve të saj, të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, si dhe të detyrimeve tregtare dhe të tjera të pagueshme përafrohet me vlerën e tyre të drejtë.

Objektivat, politikat dhe proceset e përgjithshme

Bordi ka përgjegjësinë e përgjithshme për përcaktimin e objektivave dhe politikave të menaxhimit të rrezikut të Kompanisë dhe, ndërkohë që mban përgjegjësinë përfundimtare për to, ai ka deleguar autoritetin për hartimin dhe funksionimin e proceseve që sigurojnë zbatimin efektiv të objektivave dhe politikave në funksionin financiar të Kompanisë. Bordi merr raporte mujore nga Drejtori Financiar i Kompanisë përmes të cilave ai shqyrton efektivitetin e proceseve të vendosura dhe përshtatshmërinë e objektivave dhe politikave që ai vendos. Objektivi i përgjithshëm i Bordit është të përcaktojë politika që synojnë të zvogëlojnë rrezikun sa më shumë që të jetë e mundur pa ndikuar në mënyrë të padrejtë konkurrencën dhe fleksibilitetin e Kompanisë. Detaje të mëtejshme në lidhje me këto politika janë paraqitur më poshtë:

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare për Kompaninë nëse një klient ose palë tjetër e një instrumenti financiar dështon të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Kompania është

kryesisht e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë nga shitjet me kredi. Është politikë e Kompanisë, të vlerësoj rrezikun e kredisë së klientëve të rinj përpara lidhjes së kontratave. Vlerësime të tilla kreditore merren parasysh nga praktikatat lokale të biznesit. Kompania ka krijuar një politikë kredie sipas së cilës çdo klient i ri analizohet individualisht për besueshmërinë e tij para se të ofrohen kushtet standarde të pagesës dhe dorëzimit nga Kompania. Rishikimi i Kompanisë përfshin vlerësime të jashtme, kur ka, dhe në disa raste referenca bankare. Kufijtë e blerjeve vendosen për çdo klient, që përfaqëson shumën maksimale të hapur pa kërkuar miratim nga Bordi.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut lind nga përdorimi i instrumenteve financiare me interes, të tregtueshëm dhe në valutë të huaj nga Kompania. Është rreziku që vlera e drejtë ose rrjedhat e parasë të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit (rreziku i normës së interesit), kurset e këmbimit valutor (rreziku i valutës) ose faktorë të tjerë të tregut (rreziku tjetër i çmimit).

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e pasurive me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura për financimin e këtyre pasurive.

Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është fiksuar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

4. Instrumentet financiare – menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Kompania menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që Kompania do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke maksimizuar kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të bilancit të borxhit dhe kapitalit.

Struktura e kapitalit të Kompanisë

përbëhet nga kapitali që i atribuohet zotëruesve të kapitalit, që përfshin kapitalin e emetuar dhe fitimet e pashpërndara.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind në financimin e përgjithshëm të aktiviteteve të Kompanisë dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ajo përfshin të dy, rrezikun e të mos qenurit në gjendje për të financuar pasuritë me maturitet dhe norma të interesit të përshtatshme, dhe rrezikun e të mos qenurit në gjendje për të likuiduar një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe në afatin e përshtatshëm për të përmbushur detyrimet. Kompania monitoron likuiditetin e saj në baza mujore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur ato duhet të paguhen. Maturimi kontraktual i instrumenteve financiare të Kompanisë më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 ishte si më poshtë:

Me 31 dhjetor 2025	Vlera Bartëse	1 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Gjithsej
Pasuritë afatshkurta				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	2,366,098	2,366,098	-	4,732,196
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	7,466,168	7,466,168	-	7,466,168
Stoqet	2,749,795	1,374,897	1,374,897	5,499,589
Gjithsej pasuritë afatshkurta	12,582,061	11,207,164	1,374,897	17,697,954
Detyrimet afatshkurta				
Kreditë financiare	6,585,822	3,951,493	2,634,329	6,585,822
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	5,234,206	5,234,206	-	5,234,206
Gjithsej detyrimet afatshkurta	11,820,028	9,185,699	2,634,329	11,820,028
Pozicioni i likuiditetit	762,033	2,021,464	(1,259,431)	762,033
Hapësira e likuiditetit	762,033	2,783,497	1,524,066	762,033
Koeficienti i likuiditeti	1.06	1.22	0.52	1.50
Me 31 dhjetor 2024	Vlera Bartëse	1 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Gjithsej
Pasuritë afatshkurta				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	1,255,200	1,255,200	-	2,510,400
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	4,941,623	4,941,623	-	4,941,623
Stoqet	2,060,910	1,030,455	1,030,455	4,121,819
Gjithsej pasuritë afatshkurta	8,257,733	7,227,278	1,030,455	11,573,842
Detyrimet afatshkurta				
Kreditë financiare	4,162,986	2,497,791	1,665,194	4,162,986
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	4,642,290	4,642,290	-	4,642,290
Gjithsej detyrimet afatshkurta	8,805,275	7,140,081	1,665,194	8,805,275
Pozicioni i likuiditetit	(547,543)	87,197	(634,739)	(547,543)
Hapësira e likuiditetit	(547,543)	(460,346)	(1,095,086)	(547,543)
Koeficienti i likuiditeti	(547,543)	(460,346)	(1,095,086)	(547,543)

POZHEGU BROTHERS SH.P.K.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat në Euro

5. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Gjendja e parasë në arkë dhe në bankë në fund vit është paraqitur si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Paraja në bankë	2,213,123	114,791
Paraja e bllokuar	-	1,140,245
Paraja në arkë	152,975	163
Gjithsej	2,366,098	1,255,200

6. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Llogaritë e arkëtueshme tregtare - neto	6,063,579	3,714,781
Gjithsej (I)	6,063,579	3,714,781
Huazime të dhëna	428,210	431,952
Avanset e dhëna për mallra dhe shërbime	973,810	773,665
Parapagimi i tatimeve	570	21,225
(II) Gjithsej parapagimet	1,402,590	1,226,842
(I+II) Gjithsej	7,466,168	4,941,623

7. Stoqet

Gjendja e stoqeve të kompanisë më datë është paraqitur si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Banesa	773,354	599,842
Lokale	198,872	60,006
Depo	441,403	379,781
Garazhe	897,213	690,100
Banesa garazhe depo të blera për Rishitje	416,015	303,912
Të tjera	22,937	27,269
Gjithsej	2,749,795	2,060,910

POZHEGU BROTHERS SH.P.K.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Me 31 dhjetor 2025
Të gjitha shumat në Euro

8. Prona, impiantet dhe pajisjet

Kosto	Toka	Ndërtesa dhe objektet ndërtimore	Mjete, pajisje dhe automjetet	Gjithsej
Me 31 dhjetor 2023	230,000	140,977	1,110,377	1,481,354
Rregullimet nga vitet paraprake	-	-	813	813
Blerjet (Shtesat)	1,202,800	105,295	108,598	1,416,693
Heqjet (Shlyerjet)	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2024	1,432,800	246,272	1,219,788	2,898,860
Rregullimet nga vitet paraprake	-	-	-	-
Blerjet (Shtesat)	-	-	199,082	199,082
Heqjet (Shlyerjet)	-	-	(49,323)	(49,323)
Me 31 dhjetor 2025	1,432,800	246,272	1,369,547	3,048,619
Zhvlerësimi i akumuluar				
Me 31 dhjetor 2023	-	(42,293)	(873,355)	(915,648)
Rregullimet nga vitet paraprake	-	-	-	-
Zhvlerësimi vjetor	-	(7,049)	(161,443)	(168,492)
Korigjimi për shitje dhe heqje	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2024	-	(49,342)	(1,034,798)	(1,084,140)
Rregullimet nga vitet paraprake	-	-	-	-
Zhvlerësimi vjetor	-	(7,049)	(94,602)	(101,651)
Korigjimi për shitje dhe heqje	-	(2,739)	31,405	28,666
Me 31 dhjetor 2025	-	(59,130)	(1,097,995)	(1,157,125)
Vlera neto në libra:				
Me 31 dhjetor 2024	1,432,800	196,930	184,991	1,814,721
Me 31 dhjetor 2025	1,432,800	187,142	271,552	1,891,494

9. Investimet në vijim

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Investime në vijim Projekti I Shtëpijave Sofali	14,385,618	12,623,077
Investime në vijim në Gjermani	25,050	-
Gjithsej	14,410,668	12,623,077

10. Llogaritë e pagushme tregtare dhe tjera

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	4,686,032	4,288,231
Gjithsej (I)	4,686,032	4,288,231
TVSH e pagueshme	31,388	-
Tatimi i mbajtur në burim i pagueshëm	47,839	11,972
Kontribute pensionale të pagueshme	295	10,592
Tatimi në qira i pagueshëm	6,232	1,904
Tatimi në fitim i pagueshëm	288,399	80,568
Detyrimet tatimore të pagueshme me marreveshje		-
Detyrime ndaj avanceve të pranuar	174,023	249,023
Gjithsej (II)	548,175	354,058
Gjithsej (I+II)	5,234,206	4,642,290

11. Huatë financiare

Huatë financiare paraqesin kreditë bankare dhe huazimet financiare të kompanisë të shpalosura si më poshtë:

	Me 31 dhjetor 2025	Me 31 dhjetor 2024
Pjesa afatshkurtë		
Linja kreditore	1,971,547	2,249,818
Mbitërheqja bankare	1,385,635	1,863,276
Detyrimet për kredit kartele	28,247	28,247
Huatë tjera	34,244	21,644
Gjithsej (I)	3,419,674	4,162,986
Pjesa afatgjatë		
Kredia bankare	3,166,148	2,455,977
Gjithsej (II)	3,166,148	2,455,977
Gjithsej (I+II)	6,585,822	6,618,963

12. Të hyrat

Të hyrat e kompanisë për vitin 2025 të shpalosura si më poshtë:

Për vitin që përfundon	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Të hyrat nga shitja e banesave	16,000,122	9,076,963
Të hyrat nga shitja e shtëpive	4,983,623	3,144,775
Të hyrat nga shitja e garazheve	1,162,500	481,967
Të hyrat nga shitja e depove	275,842	143,038
Të hyrat nga shitja e lokaleve	689,468	355,158
Kthimet e shitjeve	-	(8,000)
Të hyrat nga shitja e mallrave	1,995	29,661
Të hyrat nga shërbimet e mirëmbajtjes	1,936	2,340
Të hyrat nga Qiraja, Fitimet Kapitale, etj	27,330	2,100
Zbritjet e shitjeve për TMB	-	(137)
Të hyrat nga kthimi i ambalazhit	20,650	14,160
Të ardhurat tjera, ndalesat e mbajtura	822	5,000
Gjithsej	23,164,289	13,247,024

13. Kosto e mallit të shitur

Për vitin që përfundon	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Stoqet në fillim të vitit	2,060,910	2,637,783
Blerjet gjatë vitit	16,460,730	8,120,797
Sub total	18,521,640	10,758,580
 Stoqet më fund	 2,749,795	 2,060,910
Kosto e mallit të shitur	15,771,845	8,697,670

14. Shpenzimet e pagave

Për vitin që përfundon	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Pagat bruto	400,157	1,014,506
Kontributi pensional i punëdhënsit	20,008	49,540
Gjithsej	420,165	1,064,046

15. Shpenzimet operative dhe administrative

Për vitin që përfundon	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Shpenzimet e provizioneve të shitjes Vaucher & UP fee	307,225	64,238
Shpenzimet e servisimit	87,017	92,358
Shpenzimet e rrymes	53,811	29,676
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	49,379	48,126
Shpenzimet e zyres	46,085	39,498
Shpenzimet e reklames	45,842	80,578
Shpenzimet e reprezentacionit	16,328	13,435
Shpenzimet e derivateve	13,467	39,205
Shpenzimet e sigurimit të automjeteve	6,901	11,463
Donacionet e dhena	5,310	3,200
Shpenzimet e telefonit	4,933	5,590
Shpenzimet e transportimit	4,506	2,165
Shpenzimet e qirase	4,095	-
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit	3,924	4,323
Shpenzimet juridike dhe të auditimit	3,732	3,664
Shpenzimet e internetit	3,337	2,510
Shpenzimet e Regjistrimit të automjeteve	2,821	1,844
Shpenzimet për GPS të veturave	2,629	2,224
Shpenzimet e ushqimit	2,437	2,173
Shpenzimet e sigurimit të objekteve	2,295	3,347
Servisimi dhe mirëmbajtja e ashensoreve	1,759	991
Shpenzimet e shpedicionit	1,677	1,454
Shpenzimet e ngritjes profesionale	949	557
Shpenzimet e keshillimeve	855	2,554
Shpenzimet e antarsimeve	600	1,670
Shpenzimet e it-së	394	741
Shpenzimet e regjistrimit të njesive në kadastrë, projektet e mbyllura	159	169
Shpenzimet për tjetërimi mjeksorë për të punësuar	36	160
Shpenzimet e parkingut	-	10
Shpenzimet e sigurimeve shëndetsore	-	656
Shpenzimet e papranuara	66,158	49,317
Gjithsej	750,277	561,660

16. Shpenzimet financiare, neto

Shpenzimet financiare neto, paraqesin shpenzimet e interesit apo kamatës financiare e cila ndodh si rrjedhojë e financimit të kompanisë përmes kredive bankare. Shpenzimi financiar për vitin përmblyës është si mëposhtë:

Për vitin që përfundon	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
<i>Të ardhurat financiare nga depozita dhe tjera</i>	<i>32,187</i>	<i>39,933</i>
Shpenzimet e interesit	150,547	437,142
Shpenzimet administrative të kredise	1,125	4,575
Shpenzimet e shitjes UP Font Fee BKT	1,425	8,351
Shpenzimet e humbjeve valutore RBKO USD	-	4,328
Shpenzimet e provizioneve Bankare	4,400	14,780
Neto të ardhurat (shpenzimet) financiare	125,310	429,243

17. Tatimi në fitim

Kompania i nënshtrohet tatimit në fitim në bazë të ligjit 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Për vitin që përfundon	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Fitimi / (humbja) para tatimit	6,001,274	2,328,032
<i>Rregullimet mbi bazën tatimore</i>		
<i>Shpenzimet sponsorizimit të aktiviteteve të ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit të papranuara</i>	<i>66,158</i>	<i>49,150</i>
Shpenzimet e pa-zbritshme	(496)	(496)
Baza tatimore 10%	6,066,937	2,376,686
Tatimi në fitim 10%	606,694	237,669
Fitimi / (humbja) neto i/e vitit	5,460,243	2,139,017

18. Kontigjencat dhe zotimet

Detyrimet kontigjente

Me 31 dhjetor 2025 nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të kompanisë (me 31 dhjetor 2024: zero).

Çështjet ligjore

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024, kompania nuk ka qenë e involvuar në ndonjë çështje ligjore, përveq atyre që ishin normale gjatë veprimtarisë së saj.

19. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.